



Mbështetur nga BE



RAPORT

QASJA DHE PËRFSHIRJA E TË RINJVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

— RAPORT —

QASJA DHE PËRFSHIRJA E TË RINJVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

Ky publikim është mundësuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e HandiKOS dhe nuk mund të konsiderohet si reflektim pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.

Përmbajtja

1.PARATHËNIE	4
2.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	5
3.REZULTATET E HULUMTIMIT	7
Studentët me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsimin e lartë	7
Kushtet financiare	7
Infrastruktura	9
Transporti	9
Përbushja e kushteve të universitetit	11
Qëndrimet	12
Planet për të ardhmen	12
Vlerësimet e përgjithshme	14
Personat me aftësi të kufizuara jo të përfshirë në arsimin e lartë	16
Pengesat	16
Kushtet financiare	17
Infrastruktura	17
Transporti	18
Qëndrimet	19
Planet në të ardhmen	19
Vlerësimet e përgjithshme	19
Krahasimi në mes të dy grupeve	21
Demografia	22
Krahasimi i bazuar në dimensione tjera	24
Kushtet financiare	24
Transporti	25
Struktura fizike e institucioneve	25
Motivimi	25
Vlerësimet e përgjithshme	25
Planet në të ardhmen	26
4. Konkluzioni	26
5. Rekomandimet	28

1. Parathënie

Të rinjtë me aftësi të kufizuara në Kosovë janë një ndër grupet më të marginalizuara kur është fjala për mundësitë e barabarta në arsim. Këta të rinjtë sfidohen njëloj si personat me të ardhura të ulëta, pakicat etnike dhe gratë. Sipas Kushtetutës, Ligjit për mbrojtje nga diskriminimi, Ligjit për edukim parashkollor, Ligjit për arsimin parauniversitar, ligjit për arsimin në Komuna dhe Ligjit për arsimin e lartë dhe në të gjitha aktet nënligjore, është i ndaluar diskriminimi i personave me aftësi të kufizuara në çdo segment shoqëror, përfshirë edhe në arsim. Në bazë të këtyre akteve ligjore e nënligjore, çdo person me aftësi të kufizuara gëzon të drejtën për arsim njëjtë sikurse çdo person tjetër dhe është obligim i shtetit që, përmes institucioneve arsimore dhe atyre që menaxhojnë arsimin, ti regjistrojnë, akomodojnë dhe ofrojnë arsim cilësor dhe të përshtatshëm për secilin.

Megjithatë, Kosova ende përballet me sfida në konceptin e arsimit gjithëpërfshirës. Arsimi gjithëpërfshirës ka për qëllim mbështetjen e studentëve në mënyrë që ata të kenë mundësi të studiojnë në një klasë me të gjithë të tjerët, pa përjashtime. Për të arritur menaxhimin e kësaj sfide institucionet duhet të marrin përgjegjësi dhe të punojnë në drejtim të krijimit të një infrastrukture, programi dhe kuadri mësimor të duhur. Është e rëndësishme që të merren masa për të siguruar mundësi më të mira arsimore për të rinjtë me aftësi të kufizuara dhe të theksohet se sa i rëndësishëm është vazhdimi i arsimit të lartë.

Ky raport përqendrohet në pengesat që të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen në lidhje me mundësitë e barabarta arsimore në arsimin e lartë në Kosovë. Raporti gjithashtu thekson sfidat e tranzicionit në arsimin e lartë, duke përfshirë disa nga pengesat kryesore si barrierat infrastrukture, vështirësitë financiare të studentëve, transportit dhe mungesa e ndërgjegjësimit për mundësitë ekzistuese. Secila prej këtyre temave është trajtuar nëpërmjet disa pyetjeve në pyetësor, në mënyrë që të përmbliiden perceptimet të anketuarve.

Raporti përbëhet nga tri pjesë, përgjigjet e studentëve në arsimin e lartë, përgjigjet e të rinjve që nuk përfshihen në arsimin e lartë dhe krahasimin midis dy grupeve. Rezultatet e hulumtimit sqarojnë pengesat dhe mundësitë për secilin grup. Të dy grupeve iu prezantuan pyetje të ngjashme për të kuptuar pse ose pse jo të anketuarit kanë vazhduar arsimin e lartë. Në fund ky raport rekomandon disa hapa që duhen të ndërmerren për të përmirësuar mundësitë e arsimit të lartë të nxënësve me aftësi të kufizuara.

2. Metodologjia e hulumtimit

Në fazën fillestare të projektit, HANDIKOS ka zgjedhur me metodën e rastit një mostër prej 100 të rinjëve me aftësi të kufizuara për t'u intervistuar. Gjatë kësaj faze janë organizuar disa takime me qëllim të planifikimit të zhvillimit të intervistave si dhe për përzgjedhjen e individëve të cilët janë intervistuar. Të anketuarit janë përzgjedhur në mënyrë të rastësishme nga baza e të dhënave e siguruar nga HANDIKOS-i. Pyetësorët janë shpërndarë në 7 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjiilan dhe Ferizaj. Mostra e pyetësorit është formuar në bazë të:

- o Lokacionit
- o Gjinisë (Mashkull dhe femër);

Çdo intervistë ka zgjatur 20 deri në 30 minuta, varësisht nga numri i çështjeve dhe kohës së nevojshme për t'iu përgjigjur pyetjeve. Të gjitha pyetjet janë të dizajnuara për të kuptuar shqetësimet e plota të të anketuarve në mënyrë që të nxirren përfundimet me zgjidhje të përshtatshme. Duke pasur parasysh burimet e shumta të të dhënave, ato u mbledhën, u organizuan dhe analizuan me kujdes. Të dhënat e mbledhura u hartuan dhe u organizuan në mënyrë që ato të mund të përdoren me lehtësi për t'iu përgjigjur të gjitha pyetjeve dhe të jenë të krahasueshme me të dhënat tashmë të njohura. Pas mbledhjes së të gjitha të dhënave dhe futjen e gjitha të dhënave sasiore, në Paketën Statistikore për Shkencat Sociale (SPSS sistemit), gjetjes dhe vlerësimeve, janë ndërmarrë analiza të gjera. Hulumtimi ka disa implikime të rëndësishme në lidhje me trajtimin e çështjeve të nxënësve me aftësi të kufizuara në arsimin e lartë. Bazuar në rezultatet e të dhënave, ky raport do të identifikojë më tej, dhe sqarojë sfidat me të cilat të rinjtë me aftësi të kufizuara ballafaqohen gjatë përvojës së tyre akademike. Në mënyrë që pyetësi të dalë me informacionin e nevojshëm ai është përgatitur bazuar në disa dimensione, të cilat janë:

Demografia/Informacione personale	Barrierat
- Moshë - Gjinia - Vendbanimi - Niveli i arsimit - Qasja	- Shkollat (hyrja, korridoret, tualetet, klasat) - Transporti (autobusi) - Financat - Akomodimi
Qasja	Ndërgjegjësimi ndaj mundësive
- Qëndrimet ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara - Mësuesit dhe nxënësit - Normat kulturore / Komuniteti - Personeli i shkollës dhe qasja e tyre ndaj nxënësve	- Pagesa e semestrit - Të drejtat me ligj - Prioritetet për pranim - Mundësitë e bursave - Ndihma financiare
Ndikimi familjar	Planet për të ardhmen
- Motivimi familjar - Nxitja familjare - Numri i anëtarëve në familje	- Planet profesionale - Planet financiare

Të gjithë të anketuarit u janë përgjigjur pyetjeve të bazuara në dy versione të ndryshme të pyetësorit. Një version është përpiluar për të rinjtë që nuk kanë vazhduar arsimin e lartë, ndërsa një tjetër është përpiluar për ata që kanë vazhduar arsimin e lartë. Pyetësorët janë ndarë në seksione të ndryshme në bazë të elementeve të mundshme që janë pjesë e jetës sonë të përditshme. Pjesët përfshijnë mundësitë financiare dhe sfidat që të rinjtë me aftësi të kufizuara përballen, qëndrimet e tyre ndaj komunitetit, kushtet e jetesës, planet e ardhshme të karrierës etj. Bazuar në këto seksione ekipi ynë i ekspertëve ka propozuar disa rekomandime në fund të raportit final.

Të dhënat janë mbledhur nga pyetësorët që janë shpërndarë në 7 rajone të Kosovës: Prishtinë, Pejë, Prizren, Mitrovicë, Gjakovë, Gjiilan dhe Ferizaj.

Mostra														
Regjioni	Ferizaj		Gjakovë		Gjiilan		Mitrovicë		Pejë		Prishtinë		Prizren	
Gjinia	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M	F	M
Universiteti	1			1	1	1	1	1	1	1	7	3	1	1
Shkolla e mesme	4	4	4	4	5	7	6	6	6	5	4	6	7	12
Mostra sipas gjinisë	5	4	4	5	6	8	7	7	7	6	11	9	8	13
Mostra sipas regjionit	9		9		14		14		13		20		21	


Bazuar në tabelën e mësipërme të mostrës, nga 100 pjesëmarrës, 20 ishin të përfshirë në arsimin e lartë, ndërsa 80 nuk ishin të përfshirë në arsimin e lartë. Ndarja gjinore ishte pothuajse e barabartë dhe grupet u ftuan të marrin pjesë në intervistë nga shtatë rajonet e përmendura më lart. Numri i meshkujve ishte pak më i madh se i femrave; 52 meshkuj në krahasim me 48 femra. Shumica e intervistave janë kryer në Prizren, me 21 pjesëmarrës. Rajoni i dytë si qyteti me më shumë të anketuar ishte Prishtina, me 20 të anketuarve. Vendet tjera me numër më të madh pas Prishtinës ishin Gjilani, Mitrovica, Ferizaj dhe Gjakova. Disa nga të anketuarit të konfirmuar nuk kishim mundësi të marrin pjesë në seancat e pyetësorit, për këtë arsye përgjigjet e tyre u morën nëpërmjet thirrjeve telefonike. Të gjithë të anketuarit të cilët kanë udhëtuar nga vendet rurale janë rimbursuar, në mënyrë që ata të mos kishin nevojë të shpenzojnë për udhëtim..

3. Rezultatet e hulumtimit

Studentët me aftësi të kufizuara të përfshirë në arsimin e lartë


Të gjithë nxënësit e përfshirë në arsimin e lartë u janë përgjigjur pyetjeve të ngjashme me ato të cilat janë pyetur të anketuarit të cilët nuk janë të përfshirë në arsimin e lartë, megjithatë ka pasur disa ndryshime në pyetësor. Studentët kanë ndarë përvojën e tyre, mendimet dhe vendimet në lidhje me kushtet financiare, shpenzimet e jetesës, shpenzimet e shkollimit, transportit, strukturat fizike të institucioneve, qëndrimet, motivimi dhe së fundi planet për të ardhmen.

○ Kushtet financiare



Të anketuarit u pyetën nëse ata ishin në gjendje të përballojnë vazhdimin e arsimit të lartë me kushtet aktuale financiare. Me një shkallë vlerësimi prej 5 nivelesh, ku 1 ishte e barabartë me "e përballueshme" dhe 5 "e pa përballueshme," 80% e studentëve e vlerësuan këtë pyetje me nivelin 5, që do të thotë se ata mund të përballojnë shpenzimet e arsimit të lartë. Përgjigjet e tjera janë shpërndarë në mënyrë të barabartë me nga 5% e të anketuarve për çdo nivel.

○ Burimet financiare




Rreth 58% e të anketuarve thanë se burimi i tyre kryesor financiar është familja e tyre, Burimi i dytë më i madh i mjeteve financiare janë paratë e marra nga pensioni i tyre dhe të ardhurat e tjera që i marrin nga të afërmit.

Përveç kësaj, studentët u pyetën nëse ata janë të informuar në lidhje me mundësitë e bursave, 50% e të anketuarve pohuan që ata kanë informata në lidhje me bursat, 35% e tyre nuk kishin asnjë informacion për asnjërën nga mundësitë. Nga ana tjetër 15% e të anketuarve dinin se mundësi ka, por nuk kanë shumë informacione rreth tyre. Në pyetjen e bërë në lidhje me njohuritë e tyre mbi bursat komunale, 70% e nxënësve me aftësi të kufizuara konfirmuan se dinë se këto lloj të bursave ekzistojnë, megjithatë asnjë prej tyre nuk e dinte se komuna ofron bursa për çdo vit. Nga ana tjetër, 85% e tyre e dinin se universitetet private dhe publike ndajnë bursa për studentë. Kur ata u pyetën nëse ata ishin të informuar se organizatat e ndryshme joqeveritare dhe fondacionet ofrojnë bursa, gjysma e tyre konfirmuan se ata ishin të informuar për mundësitë, ndërsa gjysma tjetër jo.

○ Shpenzimet e jetesës

Pyetjet tjera në seksionin "Kushtet financiare" përfshijnë mundësitë e studentëve për të mbuluar shpenzimet e tjera universitare si librat, skriptat, fletoret, etj. Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, 45% e pjesëmarrësve u përgjigjën se këto shpenzime janë të përballueshme, 30% thanë se ato janë disi të përballueshme dhe së fundi 25% e nxënësve me aftësi të kufizuara thanë se shpenzimet e universitetit nuk ishin fare të përballueshme. Studentët me aftësi të kufizuara janë pyetur po ashtu se sa janë të përballueshme shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe shpenzimet e tjera. Grafi më poshtë tregon se 55% e studentëve vlerësuan se shpenzimet e jetesës janë të përballueshme, 25% e tyre i vlerësuan shpenzimet si disi të përballueshme dhe 20% e studentëve vlerësuan që shpenzimet e jetesës nuk ishin fare të përballueshme.



- **Infrastruktura**

Kur nxënësit me aftësi të kufizuara janë pyetur nëse kanë vizituar ndonjë universitet para se të regjistroheshin në arsimin e lartë, 55% e të anketuarve u përgjigjën me mohim. Nga ana tjetër, 45% e studentëve thanë se ata kanë vizituar universitetin para fillimit të arsimit të lartë.

- **Transporti**


Një nga faktorët më të rëndësishëm që ndikon në vendimin për të vazhduar arsimin e lartë është çështja e transportit. Studentët shfaqën shqetësimet e tyre në lidhje me mundësitë për transport, edhe pse ata ia dilnin të shkonin në universitet përkundër të gjithave. Më shumë se gjysma e studentëve thanë se familjet e tyre nuk mund t'ua siguronin transportin për në universitet prandaj u duhet të përdorin transportin publik.

Ne pyetjen “ a ka transport publik nga vendbanimi deri te universiteti”, 65% e studentëve thanë se ka autobusë për në universitet, ndërsa 35% prej tyre deklaruan se nuk ka transport publik.


Shumica e studentëve deklaruan se transporti publik ua përmbushë atyre nevojat që kanë. Megjithatë duhet të ceket se pothuajse asnjë student i intervistuar nuk është përdorues i karrocës. Është evidentuar se këta studentë kryesisht përdorin mjete tjera ndihmese siç janë: këpuca ortopedike, paterica dhe proteza.

Në pyetjen se sa ka ndikuar transporti në vazhdimin e shkollimit (1 ka ndikuar pak dhe 5 ka ndikuar shumë), nga grafi më poshtë shohim se 65% e studentëve deklaruan se qasja në transport publik ka qenë një ndër faktorët që kanë ndikuar në vazhdimin e shkollimit të tyre. Kurse 25% e studentëve të intervistuar deklaruan se transporti publik nuk ka qenë faktor vendimtar për të vazhduar shkollimin. Ndërsa 10% e tyre mendojnë se transporti ka pasur ndikim mesatar në vazhdimin e shkollimit

○ Transporti




○ Linjat e autobusëve



Në pyetjen nëse transporti publik ka qenë pengesë për vazhdimin e arsimit të lartë, 80% nga të anketuarit u përgjigjën negativisht. Ashtu si është paraqitur në grafën më poshtë, shumica e studentëve shkojnë në universitet duke përdorur një linjë të autobusit apo dy. Rreth 30% e tyre nuk përdorin transportin publik fare, kurse 30% të tjerë ndërrojnë 3 linja të autobusit për të arritur në universitet.


- **Strukturat fizike të transportit**



- **Përmbushja e kushteve të universitetit**

Në pyetjen a është pengesë për ju qasja në institucione arsimore/universitare, 75% e PAK që kanë vazhduar arsimin e lartë pohuan se nuk ka ndonjë pengesë që paraqet problem për ta. Grupi prej 15% pohuan që qasje në institucione disi paraqesin problem për ta, ndërsa vetëm 5% kanë thënë se ata e shohin atë si një problem të madh për eksperiencën e tyre akademike. Duhet të theksohet që shumica e të anketuarve nga PAK që kanë vazhduar shkollimin nuk përdorin karroca.


- **Pengesat kryesore fizike**



Studentët të përfshirë në arsim të lartë shpjeguan që një nga sfidat kryesore gjatë shkollimit të tyre është pamundësia e institucioneve të sigurojnë struktura fizike. Shqetësimi më i madh i të anketuarve (19%) ishte mungesa e tualeteve në institucione akademike. Shumica e këtyre të anketuarve që e shprehën këtë shqetësim ishin të rinjtë që përdorin pajisje ndihmëse, duke e bërë të pamundur qasjen në tualete të

zakonshme. Ndërsa shqetësimi i dytë pas mungesës së tualeteve ishte pamundësia e të rinjve për të shkuar në klasë nëpërmjet shkallëve (17.5%). Ndërsa shqetësimet e pjesës tjetër kishin të bënin me mungesën e karrigeve, tavolinave dhe dyerve të përshtatshme për vijim mësimi.

○ Akomodimi




Të anketuarit të cilët kanë vazhduar arsimin e lartë u pyetën në lidhje me zgjedhjet e tyre në lidhje me akomodim. Përderisa 50% nuk e shihnin konviktin si një mjet për akomodim, gjysma tjetër u shprehën se do të jetonin në konvikte. Kur studentët u pyetën nëse ata i shohin apartamentet apo shtëpitë me qera si mjete të akomodimit, 75% prej tyre mohuan mundësinë e akomodimit me qera, ndërsa qereku tjetër, përkrahën mundësinë e jetesës në apartment apo shtëpi me qera. Shumica e të aketuarve të cilët patën përgjigje negative, shpjeguan që problemi i akomodimit me qera është pamundësia për të jetuar i vetëm dhe kushtet financiare.

○ Qëndrimet

Raportet në mes të studentëve dhe stafit të fakultetit mund të ndikohen shumë nga natyra e aftësive të kufizuara të nxënësve. Në mënyrë që të anketuarit ta kenë më të lehtë shpjegimin e përvojave të tyre me stafin dhe studentët, të anketuarit u përgjigjën me një shkallë vlerësimi prej 5 nivelesh, ku 1 ishte e barabartë me "e papërshtatshme" dhe 5 ishte e barabartë me "shumë e përshtatshme." Rreth 75% e nxënësve me aftësi të kufizuara kanë qenë shumë të kënaqur (5) me raportet mes tyre dhe stafit të fakultetit. Përgjigja e ardhshme më e zgjedhur (10% e të anketuarve) ishte vlerësimi i këtij raporti si "i përshtatshëm."

○ Motivimi



Në pyetjet rreth motivimit, studentët duhet të përdornin një shkallë vlerësim prej 5-pikësh, ku ishte i barabartë me "jo fuqimisht të vetë motivuar" dhe 5 barabartë "fuqimisht të motivuar", kur është fjala për ata të marrin vendime. Përqindja më e lartë e të anketuarve 70%, thanë se ata ishin të motivuar fuqimisht nga vetja e tyre. Shkalla e dytë më e përgjigjur ishte niveli 1, që do të thotë se 25% e të anketuarve nuk ishin të vetë-motivuar për të vazhduar arsimin e lartë.


○ Familja

Gjetjet nga studimi tregojnë se motivimi prej familjes është shumë i rëndësishëm për studentët me aftësi të kufizuara për të vazhduar arsimin e lartë. Shumica (75%) e të anketuarve thanë se mentaliteti, zgjedhjet, si dhe vendimet e anëtarëve të familjes së tyre kanë ndikim të madh te ta. Ndërsa 25% e të rinjve vendosën numrin 1 të ndikimit të familjes, do të thotë se nuk e shihnin familjes si burim të madh motivimi.

○ Shoqëria


Të rinjtë me aftësi të kufizuara u pyetën edhe nëse ndikohen prej sjelljeve të të afërmeve dhe shoqërisë, duke e vendosur përgjigjen e tyre nga niveli 1 deri në 5, nga "aspak" deri në "tepër shumë". Mbi 50% thanë se nuk ndikohen nga sjelljet e tyre. Në anën tjetër, 45% e të anketuarve theksuan se sjelljet e të afërmeve dhe shoqërisë kanë ndikim të madh te ta. Të dhënat nga përgjigjet tregojnë se ndikimi i familjes, shoqërisë apo të afërmeve ka pothuajse rëndësinë e njëjtë.

○ Planet për të ardhmen



Të rinjtë me aftësi të kufizuara të cilët janë të përfshirë në arsimin e lartë, kishin plane që në të ardhmen të punësohen në ndonjë institucion, të kenë biznesin e tyre apo të vazhdojnë arsimin e lartë, apo plane të tjera. Shumica e tyre, përbërë nga një total prej 44.4% miratuan që do të dëshironin që të punësoheshin në një institucion, ndërsa 29.6% kanë thënë se preferonin të vazhdonin arsimin e lartë. Një numër i vogël i të anketuarve shprehën interesimin për "vetë-punësim".

○ Vlerësimet e përgjithshme



Të anketuarit vlerësuan secilin prej elementeve të cilët janë pjesë e përditshme e arsimit të lartë. Këto elemente përfshijnë mjetet financiare, infrastrukturën, transportin, strehimin, familjen, motivimin personal, komunitetin, bursat, mësimdhënësit, qëndrimet e shoqërisë, etj.. Bazuar në gjetjet e mësipërme, përgjigjet


tregojnë se këta të rinj kanë qenë të kënaqur më së shumti për shkak të përkrahjes nga familja (22.4%). Së dyti, 18.4% thanë se janë ndikuar nga kushtet financiare, dhe 15.8% i kanë shtyrë motivimi personal dhe mundësitë për transport.

Personat me aftësi të kufizuara jo të përfshirë në arsimin e lartë

Të gjithë nxënësit e përfshirë në arsimin e lartë u janë përgjigjur pyetjeve të ngjashme me ato të cilat janë pyetur të anketuarit të cilët nuk janë të përfshirë në arsimin e lartë. Kjo është bërë me qëllim që të nxjerrën krahasime në mes të këtyre dy kategorive.


○ Pengesat

Personat me aftësi të kufizuara që nuk ndjekin arsimin e lartë janë pyetur për pengesat kryesore që kanë ndaluar ata për të vazhduar arsimin e lartë. Sipas rezultateve të paraqitura në grafit më poshtë rezulton se pengesa kryesore për të mos vazhduar shkollimin e lartë është mungesa e mjeteve financiare (38.5%) e shoqëruar nga mungesa e motivit personal (21.3%). Për më shumë detaje rreth pengesave, shih grafin më poshtë:



○ Kushtet financiare

Në pyetjet financiare, të anketuarit u përgjigjën me një shkallë vlerësimi prej 5 nivelesh, ku 1 ishte e barabartë me kushte "të përballueshme" dhe 5 ishte e barabartë me "të pa përballueshme." Pyetjet klasifikuan rëndësinë e kushteve financiare në arsimin e lartë.



- **Rëndësia financiare**

Rreth, 70% e të anketuarve u pajtuan që njëra ndër faktorët kryesor që ka ndikuar në vendimmarrjen e mos vazhdimit të arsimit të lartë është barriera e kushteve financiare

- **Burimet financiare**

Rreth 48.7% e të anketuarve pohuan që burimi kryesor financiar i tyre është pagesat e marra nga familjarët e tyre. Burimi i dytë më i madh i mjeteve financiare janë paratë e marra nga pensioni i tyre, ndërsa të ardhurat e tjera ata i marrin nga të afërmit e tyre


- **Shpenzimet e jetesës**

Pyetjet e tjera në seksionin "Kushtet financiare" përfshijnë mundësitë e të anketuarve për të mbuluar shpenzimet e tjera universitare si libra, skripte, fletore etj. Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, 27.5% u përgjigjën se shpenzimet ishin të përballueshme ndërsa 72.5% e të anketuarve me aftësi të kufizuara thane se këto shpenzime universitetit nuk ishin fare të përballueshme. Studentët me aftësi të kufizuara janë pyetur po ashtu sesa janë të përballueshme shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe shpenzimet e tjera. Hulumtimet tregojnë se 26.3% e studentëve i vlerësuan shpenzimet e jetesës si të përballueshme, ndërsa 73.8% e studentëve vlerësuan që shpenzimet e jetesës nuk ishin fare të përballueshme.

- **Infrastruktura**


Kur të anketuarit me aftësi të kufizuara janë pyetur se sa është e rëndësishme infrastruktura përcjellëse në universitete, 65% e të anketuarve e vlerësuan si barrierë shumë të rëndësishme në mos vazhdimin e shkollimit. Ne anën tjetër 17.5% e të anketuarve nuk e shikonin infrastrukturën si barrierë me shumë rëndësi.

- **Përmbushja e kushteve te infrastrukturës së universitetit per PAK**



Të anketuarit jo të përfshirë në arsim të lartë shpjeguan që një nga sfidat kryesore që ka ndikuar në mos vazhdimin e shkollës së lartë është pamundësia e institucioneve të sigurojnë struktura fizike. Shumica e universiteteve kanë nevojë për disa struktura të posaçme për të lehtësuar përvojën e tyre në universitet. Shqetësimi më i madh i të anketuarve jo të përfshirë në arsim të lartë ishte mungesa e tualeteve në institucione akademike. Shumica e këtyre të anketuarve përdornin pajisje të tilla si karrige me rrota. Paterica etj., duke e bërë të pamundur qasjen në tualete të zakonshme. Ndërsa shqetësimi i dytë pas mungesës së tualeteve ishte pamundësia e të rinjve për të shkuar në klasë nëpërmjet shkallëve. Rreth 16.8% pohuan që ata nuk mund të ecin shkallët, apo kanë vështirësi gjatë procesit të kalimit të tyre. Shqetësimi i tretë i të anketuarve ishte mungesa e karrigeve të përshtatshme për vijim mësimi.


○ Akomodimi



Të anketuarit jo të përfshirë në arsim të lartë u pyetën në lidhje me zgjedhjet e tyre akomoduese. 51.3% e të anketuarve e shihnin akomodimin në konvikte si një mundësi për të vazhduar shkollimin ndërsa grupi i mbetur nuk e shihnin akomodimin në konvikte si një mundësi. Kur studentët u pyetën nëse ata i shohin apartamentet apo shtëpitë me qera si mjete të akomodimit, 75% prej tyre mohuan mundësinë e akomodimit me qera, Ndërsa qereku tjetër, konfirmuan mundësinë e jetesës në apartament apo shtëpi me qera. Shumica e të anketuarve të cilët patën përgjigje negative, shpjeguan që problemi i akomodimit me qera është pamundësia për të jetuar vetëm dhe kushtet financiare.

○ Transporti

Mundësitë për transport



Një faktorë i rëndësishëm që ndikon në vendimin e të rinjve për të vazhduar arsimin e lartë është çështja e transportit. Shumica e të rinjve që jetonin në fshatra shfaqën shqetësimet e tyre në lidhje me mundësitë për transport. Megjithatë edhe të rinjtë që jetojnë në qytet shumicën e rasteve duhet të udhëtojnë në Prishtinë në mënyrë që t'i ndjekin mësimet me rregull. Rreth 55% e të anketuarve u shprehën që ata kishin problem me transport, dhe se familja e tyre nuk mund t'u siguronte mundësi transporti.


○ Qëndrimet

Raportet në mes të personave me aftësi të kufizuara (që nuk kanë vazhduar studimet) dhe stafit të shkollës supozohet se mund të ndikohen shumë nga natyra e aftësive të kufizuara të këtyre personave. Të pyetur se si e vlerësoni sjelljen e stafit dhe shoqërisë ndaj jush gjatë shkollimit, rreth 54% e personave me aftësi të kufizuara (që nuk kanë vazhduar studimet) kanë deklaruar se sjellja e stafit të shkollës ka qenë e mirë.


Të rinjtë me aftësi të kufizuara u pyetën edhe nëse ndikohen prej mendimeve të të afërmeve dhe shoqërisë gjatë vendimmarrjes. Mbi 40% thanë se nuk ndikohen nga mendimet e të afërmeve dhe shoqërisë gjatë vendimmarrjes.

○ Motivimi

Personave me aftësi të kufizuara, pavarësisht se nuk kanë mundur të vazhdojnë shkollimin e lartë, kur janë pyetur “A keni pasur dëshirë të vijoni shkollimin e lartë”, shumica e tyre (77.5%) kanë deklaruar se kanë shumë apo tepër shumë dëshirë për të vazhduar shkollimin e lartë. Në vazhdim, ata që janë përgjigjur se kanë shumë apo tepër shumë dëshirë për të vazhduar shkollimin e lartë, janë pyetur “Cilët janë faktorët kryesorë që ju ngjallin dëshirën për shkollimin e lartë”. Rezultatet tregojnë se mundësia për punësimin në të ardhmen është një ndër faktorët kryesor që ngjall dëshirën për të vazhduar shkollimin. Për më shumë detaje shih grafën poshtë:




○ Planet në të ardhmen



Të rinjtë me aftësi të kufizuara të cilët nuk janë të përfshirë në arsimin e lartë, ishin pyetur nëse ata kishin plane për të ardhmen për tu punësuar në ndonjë institucion, të kenë biznesin e tyre, të vazhdojnë arsimin e lartë, apo plane të tjera. Shumica e tyre, duke përmblodhur një total prej 57.4% miratuan që do të dëshironin që të punësoheshin në një institucion, ndërsa 13.9% kanë thënë preferonin të vazhdonin arsimin e lartë. Një numër i vogël i të anketuarve u përgjigjen në lidhje me interesin e tyre për të filluar ndonjë kurs për gjuhë të huaja.

○ Vlerësimet e përgjithshme




Të anketuarit vlerësuan secilin prej elementeve të cilat janë pjesë e përditshme e arsimit të lartë. Këto elemente përfshijnë mjete financiare, infrastrukturë, transport, strehim, familjen, motivimi personal, komunitetin, bursa, mësues dhe qëndrimet e mikut së. Bazuar në gjetjet e mësipërme, përgjigjet kryesore për të cilat këta të rinjë me aftësi të kufizuara kanë qenë më të influencuar janë mjetet financiare (38.5%). Së dyti, 21.4% janë influencuar nga motivi personal, dhe 11.5% janë influencuar nga kushtet e akomodimit.

4. Krahasimi në mes të dy grupeve


Demografia

Jo të përfshirë në arsim të lartë

Gjinia



Të përfshirë në arsim të lartë





Duke u bazuar në grafën e sipërm, shumica e të intervistuarve të cilët nuk e kanë vazhduar shkollimin e lartë ishin meshkuj (55%). Në anën tjetër shumica e të intervistuarve të cilët kanë ndjekur shkollimin e lartë ishin femra (40%). Të gjeturat tregojnë se femrat kanë më shumë gjasa të vazhdojnë shkollimin e lartë se sa meshkujt.

Statusi familjar

Studimi tregon që shumica e të dy grupeve janë përgjigjur pothuajse njëjte. Rreth 75% e të intervistuarve në edukim të lartë, dhe 90% e të intervistuarve që nuk janë të përfshirë në edukim të lartë, janë beqar.

Statusi i punës





Rreth 80% e të intervistuarve të rinjtë në të dy grupet ishin të papunë. Rreth 87.5% e njerëzve të cilët nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë ishin të papunë, përderisa 80% e njerëzve në edukimin e lartë ishin gjithashtu të papunë. Vetëm një grup i vogël i njerëzve (12.5% dhe 20%) ishin të punësuar.

Pensioni mbështetës për persona me aftësi të kufizuara.

Studimi tregon që shumica nga të dy grupet merr pension mbështetës. Rreth 70% e tyre në edukim të lartë dhe 63% e tyre jo të përfshirë në edukim të lartë marrin ndihmë financiare prej pensioneve.

- **Statusi ekonomik familjar**





Të dy grupet të cilët i përfshijnë ata të cilët kanë vazhduar shkollimin e lartë dhe ata të cilët nuk e kanë vazhduar shkollimin e lartë tregojnë që vijnë prej familjeve me të ardhura mesatare. Të dhënat korrespondojnë me 72.5% me grupin të cilët nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë dhe 85% për ata të cilët e kanë përfunduar shkollimin e lartë.

- **Anëtarët e familjes që aktualisht janë të përfshirë në edukim të lartë.**


Studimi tregon që shumica e tyre që janë në edukim të lartë, kanë edhe vëllezër ose motra të cilët ndjekin studimet, ndërsa një përqindje më e ulët (43.8%) e tyre që nuk janë të përfshirë në edukim të lartë kanë pohuar se kanë motra ose vëllezër që studiojnë.

- **Vendbanimi**




Shumica e të intervistuarve prej të dy grupeve jetojnë në qytet. Duke u bazuar në të dhëna, 61.3% e të rinjve të cilët nuk e kanë ndjekur shkollimin e lartë dhe 60% e njerëzve të cilët kanë përfunduar shkollimin e lartë.

○ Përdorimi i mjeteve ndihmëse



Shumica e të intervistuarve, rreth 54.5% të cilët nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë janë përdorues të karrocave, Të tjerët janë ata me aftësi të kufizuara që përdorin proteza (13.6%), ndërsa (9.1%) e atyre me aftësi të kufizuara që përdorin këpucët ortopedike dhe kukëzat.



Krahasuar me grafën a) i cili i përshkruan pajisjet ndihmëse të intervistuarve pa edukim të lartë, grafi b) tregon për pajisjet ndihmëse që përdorin ata të cilët kanë kompletuar edukimin e lartë, e që janë këpuca ortopedike dhe proteza (25% nga secila). Mjetet tjetera ndihmëse me të përdorura janë kukëzat dhe kukëzat me mbështetje të bërrylit. Ndërsa të gjeturat tregojnë që asnjë prej të intervistuarve të cilët e kanë vazhduar shkollimin e lartë, nuk janë përdorues të karrocave.

Krahasimi i bazuar në dimensionet tjera

○ Kushtet financiare

Kur studentët me aftësi të kufizuara janë pyetur se a mundën të përballojnë financiarisht vazhdimin e shkollimit të lartë me vet financim, ata janë përgjigjur se mundën, mirëpo ata varen nga mënyra e transportit të tyre. Në anën tjetër, 70% e të intervistuarve të cilët nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë u përgjigjën që arsyeja kryesore për mos vazhdimin e shkollimit të tyre janë mjetet financiare. Kjo nënkupton që burimet financiare janë një pengesë kryesore për ta vazhduar edukimin

- **Transporti**

Kur t'i krahasojmë mendimet e të dy grupeve që kanë problem transportin, shumica u pajtuan që transporti nuk ishte pengesë për vendimin e tyre që ta vazhdojnë edukimin e lartë. Të gjithë këta studentë nuk ishin përdorues të karrocës si mjet ndihmës për lëvizje. Rreth 65% e studentëve që vazhduan edukimin e lartë u përgjigjen që transporti i plotëson nevojat e tyre. ***Megjithatë duhet të ceket se këta të anketuar nuk janë përdorues të karrocave.***

35% e të intervistuarve (që nuk kanë vazhduar shkollimin e lartë), u përgjigjen që transporti nuk është pengesë kryesore për vazhdimin e shkollimit.

- **Struktura fizike e institucioneve**

Prej të dy grupeve, të intervistuarit që kanë vazhduar edukimin e lartë dhe ata që nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë u pajtuan që problemi fizik më i madh i tyre në institucione akademike është mungesa e tualeteve, shkallëve dhe deryve adekuate. Këto pengesa i kufizon këta që të ndjekin të njëjtat aktivitete dhe programe me kolegët e tyre që janë pa aftësi të kufizuara.

- **Motivimi**

Shumica e studentëve (75%) u përgjigjen që janë fuqishëm të influencuar nga anëtarët e tyre të familjes si nga ana e kulturës, vendimeve dhe zgjedhjeve, pak a shumë njëjtë u përgjigjen. Po ashtu shumica e atyre që nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë, se edhe ata janë fuqishëm të influencuar nga anëtarët e tyre të familjes. Po ashtu, 41.3% u përgjigjen që familjet e tyre i motivojnë që të vazhdojnë universitetin. Të dhënat e studimit tregojnë që të intervistuarit janë shumë të motivuar dhe të influencuar nga anëtarët e tyre të familjes, mirëpo ata nuk janë edhe shumë të ndikuar nga të afërmit dhe shokët në vendimet e tyre.

- **Vlerësimet e përgjithshme**

Rezultatet tregojnë që studentët që kanë vazhduar edukimin e lartë, janë të motivuar nga anëtarët e tyre të familjes që të shkojnë në universitet, si rrjedhojë, mjetet financiare janë disi të menaxhushme që ti mbulojnë të gjitha shpenzimet. Në anën tjetër, grupi i dytë pruan që mungesa e mjeteve financiare dhe motivimi personal kanë ndikuar negativisht në vendimin e tyre për ta vazhduar edukimin e lartë. Studimi tregon që përderisa të dy grupet janë të influencuar nga familjet e tyre, studentët të cilët kanë vazhduar edukimin e lartë, janë më shumë të vetë motivuar dhe optimist për ti mbuluar të gjitha shpenzimet.

○ Planet në të ardhmen

Përderisa 44.4% e studentëve e pranuan që ata kanë dëshirë të punësohen nga ndonjë institucion, 57.4% e të intervistuarve të cilët nuk e kanë vazhduar edukimin e lartë u përgjigjen që kanë plane të njëjta në të ardhmen. Në anën tjetër, një numër i vogël i dy grupeve synojnë që të kenë bizneset e tyre apo të fillojnë ndonjë program profesional.

5. Konkluzioni

Qëllimi i këtij hulumtimi ishte shqyrtimi i përvojave arsimore të të rinjve me aftësi të kufizuara fizike, dhe në veçanti përvojat që ata kalojnë pas mbarimit të shkollës së mesme. Gjithashtu, qëllimi i hulumtimit ishte që të identifikohen faktorët të cilët ndikojnë në vendimin e tyre për të vazhduar apo jo arsimin e lartë. Me pas të bëhet përmbledhja e të gjitha gjetjeve kryesore që të shpijnë drejt rekomandimeve të caktuara të cilat janë të bazuara në informacionin e dhënë nga të anketuarit.

Gjetjet janë bazuar në intervistat e 100 personave me aftësi të kufizuara, në veçanti të rinjtë mes moshës 18 dhe 28 vjeç. Nga 100 e të anketuarve, 80 persona nuk ishin të përfshirë në arsimin e lartë, ndërsa 20 persona ishin të përfshirë në arsimin e lartë. Të anketuarit kanë plotësuar kriteret e synuara në lidhje me moshën, aftësi të kufizuar fizike dhe përvojë apo jo në institucionet arsimore. Të anketuarit kishin aftësi të kufizuara fizike të ndryshme, duke përfshirë nivele të ndryshme të vështirësisë me aktivitete të caktuara, të tilla si vështirësi në lëvizje duarsh, këmbësh etj.

Në hulumtim janë përfshire një numër pak më i madh i gjinisë mashkullore se sa gjinisë femërore. Të anketuarit përfshinin (52) meshkuj në krahasim me (48) femra. Gjatë hulumtimit janë përfshirë të rinjtë nga qytetet dhe zonat rurale të ndryshme përreth Kosovës prandaj, përvojat e këtij grupi kanë reflektuar çështjet me të cilat të rinjtë ballafaqohen në të dy pjesët gjeografike. Të anketuarit i janë përgjigjur pyetjeve rreth të dhënave demografike të cilat janë mbledhur për qëllime të raportimit, sidoqoftë atyre i është garantuar konfidencialiteti i përgjigjeve të dhëna. Të anketuarit i janë përgjigjur pyetësorit brenda kohës së parashikuar të rreth 20 minutave. Në bazë të intervistave, të anketuarit me aftësi të kufizuara që nuk kanë vazhduar arsimin e lartë mbeten prapa grupit të kundërt kur flasim për përgatitjen e tyre për universitet. Ndërsa, studentët me aftësi të kufizuara që vazhduan arsimin e lartë ishin më të përgatitur emocionalisht dhe akademikisht për të vazhduar arsimin e lartë, të anketuarit që nuk kishin vazhduar, kishin më pak mundësi kualifikimi për pranim në

universitet, në mënyrë specifike për të kryer kurse të nivelit universitar. Disa nga gjetjet kryesore të këtij studimi, në të cilin janë bërë krahasimet e vendimmarrjes dhe zgjedhjeve të të dy grupeve: ato të përfshira në arsimin e lartë dhe ata nuk tregojnë se shumica e të anketuarve janë të ndikuar nga këta faktorë:

Kushtet Financiare – Bazuar në hulumtim, të dy grupet janë të brengosur me mundësitë e tyre financiare, dhe këtë problem e shohin si një pengesë me rëndësi për vazhdimin e arsimit të mëtejshëm.

Transporti - Pjesa më e madhe e të anketuarve të të dy grupeve u pajtuan se transporti nuk ishte pengesë kryesore për të vazhduar apo jo arsimin e lartë, megjithatë ata sfidohen në baza ditore me mundësitë e transportit publik.

Struktura fizike e ana e institucioneve - Mungesa e strukturave të duhura fizike në institucionet tona është një sfidë për të gjithë të anketuarit me aftësi të kufizuara. Mungesa e strukturave të cilat janë përzgjedhur si më sfiduese nga të dyja grupet janë: tualetet, shkallët dhe dyert. Çfarë ka reflektuar më shumë në këtë fazë të hulumtimit është fakti që të dy grupet kishin të njëjtin qëndrim lidhur me rëndësinë e të gjitha barrierave fizike.

Motivimi - Nxënësit me aftësi të kufizuara përfshirë apo jo në arsimin e lartë e shprehën rëndësinë tejet të lartë të familjes rreth vendimmarrjes së tyre, megjithatë studentët që ndjekin universitetin kishin më shumë tendencë për vetë motivim.

Planet për të ardhmen - Të dy grupet kanë treguar interes më të madh për t'u punësuar në institucioneve, në anën tjetër një përqindje e ulët e të anketuarve shprehën interesim për vetë-punësim apo për të filluar vijimin e ndonjë programi profesional.

Si përfundim, të rinjtë me aftësi të kufizuara kalojnë nëpër sfida dhe përballen me vështirësi përgjatë marrjes së vendimeve në lidhje me vazhdimin e arsimit të lartë. Përderisa një numër i paktë i tyre vazhdojnë arsimin e lartë, të tjerët janë të lënë anash në mbështetje financiare të familjarëve të tyre, apo mbështetje të vogël që ata marrin nga pensionet e tyre. Barrierat si çështjet financiare, mungesa e transportit, mungesa e strukturës fizike të institucioneve, çështjet e akomodimit dhe mungesa e vetë-motivimit- janë shumë të theksuar në të dy grupet, megjithatë të anketuarit të cilët nuk e kanë vazhduar arsimin e lartë janë më të prekur për çështje të tilla. Bazuar nga hulumtimet mbi barrierat, duhet të ndërmerren masa dhe të krijohen mekanizma për të për të përmirësuar dhe stimuluar studentët me aftësi të kufizuara për të vazhduar arsimin e lartë. Disa nga rekomandimet të cilat mund të merret në konsideratë janë paraqitur në seksionin më poshtë.

6. Rekomandimet

Hapat e rekomanduara që duhen ndërmarrë për të mbështetur vazhdimin e arsimit të lartë të nxënësve me aftësi të kufizuara

Rekomandimi 1: *Zhvillimi i politikave për ndihmë financiare për të reduktuar sfidat në të cilat studentët e diplomuar kalojnë*

Ne rekomandojmë zhvillimin e politikave, praktikave dhe burimeve që synojnë heqjen e pengesave financiare për vazhdimin e arsimit të lartë. Në bazë të hulumtimit, një nga çështjet më të rëndësishme me të cilën të anketuarit janë ballafaquar, ishte mungesa e stabilitetit financiar. Shumica e të anketuarve të cilët nuk e kanë vazhduar arsimin e lartë u përgjigjën se pengesa më e madhe për të mos vazhduar shkollimin ishin: pamundësia financiare për të mbështetur shkollimin, mungesa e mjeteve shkollore dhe shpenzimet e përgjithshme të jetesës.

Rekomandimi 2: *Përmirësimi në qasjen fizike të mjeteve dhe objekteve shkollore*

Ne rekomandojmë që objektet arsimore të përmirësojnë dhe përshtatin infrastrukturën fizike, në mënyrë që tua lehtësojnë nxënësve me aftësi të kufizuara të kenë qasje të lehtë në hyrje, salla, klasa, tualete etj. Bazuar në përgjigjet e të anketuarve, asnjë nga të intervistuarit që janë përdorues të karrocave nuk kanë vazhduar arsimin e lartë. Të anketuarit ishin të shqetësuar për mungesën e qasjes në hyrje të objekteve shkollore, tualeteve, tavolinave, ashensorëve dhe dyerve.

Rekomandimi 3: *Përmirësimi e qasjes së barabartë në konvikte*

Ne rekomandojmë që të përmirësohet dhe rregullohet qasja e dhomave të strehimit/konviktit për të lehtësuar studentët me aftësi të kufizuara që të kenë kushte banimi. Pothuajse gjysma e të anketuarve nuk i shohin konviktet si një zgjidhje duke pasur parasysh mungesën e qasjes fizike të përshtatshme për studentët me aftësi të kufizuara.

Rekomandimi 4: *Përmirësimi i qasjes në informacion, mbështetjen dhe të drejtat*

Ne rekomandojmë që studentët me aftësi të kufizuara duhet të pajisen me informacione në lidhje me mbështetjen financiare, ndihmën e mëtejshme që duhet ofruar atyre dhe tu gjinden burime të ndryshme të mundësive. Përveç kësaj, gjatë intervistës shumica e të anketuarve të cilët nuk e kanë vazhduar arsimin e lartë kanë shprehur shqetësimin e tyre në lidhje me shpenzimet shkollore të tilla si: libra, skripta etj.

Rekomandimi 5: *Sigurimi i transportit të lehtë për tu qasur*

Të bëhet sigurimi i shërbimeve me kosto efektive të transportit për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe gjithashtu të inkurajohen programet e pavarura të udhëtimit. Përveç kësaj, automjetet e udhëtimit duhet të jenë të qasshëm për nxënësit me aftësi të kufizuar që janë përdorues të karrocave dhe me pajisje tjera ndihmëse.

Rekomandimi 6: *Qasja dhe mundësia e barabartë në programe, aktivitete dhe shërbime shkollore*

Dhënia e mundësive të barabarta për aplikuesit e kualifikuar me aftësi të kufizuara për të pasur qasje në përfitimet dhe privilegjet e programeve, aktiviteteve dhe shërbimeve tjera shkollore. Shumica e të rinjve të përfshirë ose jo në arsimin e lartë nuk janë në dijeni të bursave dhe programeve që ata mund të përfitojnë. Duke ju ofruar mundësi arsimore dhe aktivitete tjera mbështetëse, të rinjtë me aftësi të kufizuar do të motivohen për të vazhduar arsimin e lartë.

Rekomandimi 7: *Përmirësimi i qasjes në materiale me formate alternative*

Ne rekomandojmë që departamentet akademike dhe bibliotekat universitare të punojnë së bashku për gjetur mënyra për të rritur sigurimin e materialeve me formate alternative për studentët me aftësi të kufizuara që vazhdojnë arsimin e lartë. Çdo format i materialeve akademike coftë të përdorura, elektronike, letre, të gjitha janë të rëndësishme për vazhdimin e arsimit të lartë.

Rekomandimi 8: *Sigurimi në qasje dhe ndërgjegjësim në fondet bamirëse dhe programet e bursave*

Ne rekomandojmë që institucionet të japin më shumë informacion dhe burime se si të arrihen bursat, dhe si të kenë qasje në fondet e bamirësisë.

Rekomandimi 9: *Njohja e arritjeve akademike, si nxitje për motivim*

Ne rekomandojmë që institucionet të njohin suksesin e nxënësve përmes metodave të ndryshme, të tilla si shpërblime dhe programe për të rritur pjesëmarrjen dhe motivimin e studentëve me aftësi të kufizuara. Pjesa më e madhe e të anketuarve treguan një interes të lartë për nxitje dhe motivim. Një nxitje dhe mbështetje do të jetë motivim i cili do të shërbejë pozitivisht për vazhdimin e arsimit të lartë.

Rekomandimi 10: *Organizimi i fushatave mediale*

Fushata mediale është shumë e rëndësishme, duke pasur parasysh që studentët, familjet e tyre dhe shoqëria në përgjithësi kanë nevojë të informohen rreth mundësive dhe rëndësisë së vazhimit të shkollimit. Duke pasur parasysh se shumica e të anketuarve ishin të ndikuar nga kulturat e tyre familjare dhe shoqëria, fushata do të ishte një mundësi e madhe për të përmirësuar gjendjen aktuale të arsimit të lartë në Kosovë. Multimedia, të tilla si marketing me aplikacione telefonike, podcasting, foto, video, media sociale, TV dhe radio mund të promovojnë rëndësinë e arsimit të lartë dhe zhvillimin e vetëdijes në një mënyrë shumë të veçantë dhe të fuqishme.

— RAPORT —

QASJA DHE PËRFSHIRJA E TË RINJVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

Ky publikim është mundësuar me asistencën e Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e HandiKOS dhe nuk mund të konsiderohet si reflektim pikëpamjeve të Bashkimit Evropian.



Mbështetur nga BE



RAPORT

QASJA DHE PËRFSHIRJA E TË RINJVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË